



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 104/2018

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 9374, DATË 21.4.2005,
“PËR NDIHMËN SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë:

Neni 1

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

Përjashtimi nga përfitimi i ndihmës shtetërore

1. Subjekti përjashtohet nga përfitimi i ndihmës shtetërore nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e veprës penale:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;

dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;

ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

2. Përjashtimi nga përfitimi i ndihmës shtetërore zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose

mbikëqyrës i subjektit përfitues të ndihmës, në kuptim të këtij ligji, aksionar ose ortak i tij, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

3. Me qëllim plotësimin e kushteve për të përfituar ndihmën shtetërore, subjekti përfitues i ndihmës duhet të paraqesë vërtetim mbi gjendjen gjyqësore, ose një dokument të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 13.12.2018